VENDIM
Nr. 571, datë 18.9.2024

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK MINISTRIA E BRENDSHME, TË PRONËS ME EMËRTIM "ISH-GRUP-DEPO MUNICIONI", ME VENDNDODHJE NË GRIZË, FIER, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, SI DHE PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes tek Ministria e Brendshme, për Policinë e Shtetit, të pronës me nr. rendor 808, me emërtim "Ish-grup-depo municioni", me vendndodhje në Grizë, Fier, me numër pasurie 100/1, zona kadastrale 2411, sipas planit të rilevimit bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për ta përdorur për sistemimin dhe ruajtjen e mjeteve lundruese të konfiskuara.
2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, dhe i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik", të ndryshuar.
3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Prona nr.808 "Ish Grup Depo Municioni" Grizë, Fier
(Transferim nga Ministria e Mbrojtjes tek Ministria e Brendshme)

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM, (KM) DATË 19/03/2024 QËLLIMI Transferim nga MM tek MB

VENDNDODHJA
Bashkia Fier ZVASHK Fier Nr.Pasurisë 100/1 Z.K 2411 Indeksi i Hartës K-34-112-(244-A)

TE DHËNAT E PASURISË
Lloi i pasurisë Truall Sip e pasurisë **47192.99m²** Sip e gjurmës së ndërtimit **11326.5m²** Nr. kateve 1 Nr. pemeve

Nord =4505898.56
East = 465665.39

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord =4505898.56
East = 466105.30



Nord =4505547.49
East = 465665.39

SH 1: 2500
METRA

Nord =4505547.49
East = 466105.30

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID NIPT
1	Ver				K51726024H
2	Lindje				
3	Jug				
4	Perendim				

REALIZOI PËR IGJIU
Topograf Ramiz Haxhiu

KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI MArch. Teuta **KANXHERI**

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti
DVASHK
Nënshkrimi
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori
Nënshkrimi/ Vula

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto.
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas dokumentacionit hartografik arkivor.
Shënim: Ky plan rilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Komandës Mbështetëse nr.1493, datë 18.03.2024. Bazuar në dokumentacionin hartografik marrë në arkivin e IGJIU-s, Kartelës të pasurisë së paluajtshme, HTR-së b/lidhur shkresës, ortofoto e vitit 2015-2016.

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM (Komanda Mbështetëse)
MIRATOHET
ZV/KOMANDANTI I KOMANDËS MBËSHTETËSE
Kolonel Shkëlqim **ÇELA**